

“A&E ENGINEERING” Shpk

Pasqyrat Financiare

Për ushtrimin e mbyllur më
31 Dhjetor 2021

NIPT K72113010E

Njesia Bashkiake Nr.10, Rr.Islam Alla
Pallati IVEA 3/5
Tirane

Eupho Leo



PERMBAJTJA:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)

PASQYRA E PERFORMANCËS

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE

	6
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	7
2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare	7
3. Politikat kontabël	8
5. Mjete monetare	13
6. Llogari të arkëtueshme tregtare	13
7. Kërkesa të arkëtueshme nga palet e lidhura	13
8. Të tjera llogari të arkëtueshme	13
9. Aktivët afatgjatë materiale	14
10. Llogari të pagueshme tregtare	14
11. Detyrime tatimore	14
12. Të ardhura të shtyra	15
13. Të tjera detyrime	15
14. Kapitali	15
15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15
16. Lënde e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shërbime	15
17. Shpenzime për personelin	16
19. Tatimi mbi fitimin	16
20. Angazhime dhe pasiguri	17
21. Ngjarje pas datës së bilancit	17



A&E Engineering” shpk
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat në leke)

AKTIVET	Shenime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Aktivitet Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	7,365,860	35,245,145
Llogari te arketueshme tregtare	5	68,705,987	67,076,602
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura		-	5,344,304
Te tjera llogari te arketueshme		-	865,912
Automjete per shitje	6	14,899,186	
Shpenzime te shtyra		-	-
Total Aktive afatshkurtra		90,971,033	108,531,963
Aktivitet Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	11,874,977	20,260,411
Aktivitet afatgjata jomateriale		-	-
Totali per Aktivitet Afatgjata		11,874,977	20,260,411
Totali i Aktiveve		102,846,009	128,792,374
DETYRIMET			
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregtare	8	20,895,681	54,341,230
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	9	2,871,128	-
Detyrimet tatimore	10	6,998,176	4,904,602
Te ardhura te shtyra	11	43,424,987	25,840,000
Te tjera detyrime	12	537,669	1,011,786
Totali per Detyrimet Afatshkurtra		74,727,640	86,097,618
Detyrimet Afatgjata			
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura		-	-
Provizione		-	-
Totali per Detyrimet Afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		74,727,640	86,097,618
KAPITALI			
Kapitali I nenshkruar	13	120,000	120,000
Rezerva ligjore			
Rezerva te tjera			
Fitimet e pashperndara		8,260,870	32,403,460
Fitimi/Humbja e vitit financiar		19,737,499	10,171,297
Totali per Kapitalin		28,118,369	42,694,757
Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit		102,846,009	128,792,374

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021, u aprovuan nga Entela Cano me 11.03.2022 dhe u nenshkrua si me poshte:

Administratori
Entela CANO



Pasqyra e Performancës
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)
Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas Natyrës

	Shenime	Vit I mbyllur me 31 dhjetor 2021	Vit I mbyllur me 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	85,924,332	81,740,353
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	16	(40,644,538)	(50,432,287)
<i>1. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		(40,644,538)	(50,432,287)
<i>2. Të tjera shpenzime</i>		-	-
Shpenzime të personelit	17	(17,108,498)	(14,199,319)
<i>1. Paga dhe shpërblime</i>		(14,692,132)	(12,202,055)
<i>2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(2,416,366)	(1,997,264)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(4,554,378)	(5,142,782)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime të tjera shfrytëzimi		-	-
Te ardhura/ Shpenzime financiare	18	(136,525)	267
<i>1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</i>		-	-
<i>2. Shpenzime /Te ardhura të tjera financiare</i>		(136,525)	267
Fitimi/Humbja para tatimit		23,480,394	11,966,231
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	(3,742,895)	(1,794,935)
<i>1. Shpenzimi i tatim fitimit të periudhës</i>		(3,742,895)	(1,794,935)
Fitimi/Humbja e vitit		19,737,499	10,171,297

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021, u aprovuan nga Entela Cano me 11.03.2022 dhe u nenshkrua si me poshte:

Administratori
 Entela CANO



“A&E Engineering” shpk


Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

**Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto
Per Vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019	120,000	-	28,514,772	-	28,634,772
Fitimi / Humbja e vitit			-	13,888,688	13,888,688
Levizje permes kapitalit					-
Dividendë të paguar			(10,000,000)	-	(10,000,000)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	120,000	-	18,514,772	13,888,688	32,523,460
Fitimi / Humbja e vitit			-	10,171,297	10,171,297
Levizje permes kapitalit			13,888,688	(13,888,688)	-
Dividendë të paguar			-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	120,000	-	32,403,460	10,171,297	42,694,757
Fitimi / Humbja e vitit			-	19,737,499	19,737,499
Levizje permes kapitalit			-	-	-
Dividendë të paguar			(34,313,887)	-	(34,313,887)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	120,000	-	(1,910,427)	29,908,796	28,118,369

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021, u aprovuan nga Entela Cano me 11.03.2022 dhe u nënshkrua si me poshte:

Administratori
Entela Cano



A&E Engineering” shpk**PASQYRA E LEVIZJES SE FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE (CASH FLOW)**

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat në leke)

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	19,737,499	10,171,297
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>	-	-
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	4,554,378	5,142,782
<i>Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	4,580,831	(30,254,062)
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>	-	-
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	(11,369,977)	40,124,731
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	17,502,730	25,184,748
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit		
<i>a. Para të përdorura për blerjen e filialeve</i>		
<i>b. Para të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
<i>c. Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	(163,331)	(847,640)
<i>d. Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	-	12,127
<i>e. Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>		
<i>f. Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
<i>g. Dividendë të arkëtuara</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e investimit	(163,331)	(835,513)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit		
<i>a. Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
<i>b. Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>	-	-
<i>c. Hua të arkëtuara</i>		
<i>d. Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
<i>e. Riblerje e aksioneve të veta</i>		
<i>f. Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>g. Pagesa e huave</i>		
<i>h. Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>		
<i>i. Interes i paguar</i>		
<i>j. Dividendë të paguar</i>	(34,313,887)	-
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e financimit	(34,313,887)	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(16,974,488)	24,349,236
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	35,245,145	10,895,909
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	18,270,656	35,245,145

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021 u aprovuan nga Entela Cano me 11.03.2022 dhe u nenshkrua si me poshte:

Administratori
Entela CANO



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria "A&E Engineering" shpk, është themeluar prane QKR më date 02/09/2007. Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj aktualisht në Tiranë, Adresa: Njesia bashkiake nr. 10, Rr. "Islam Alla" Pallati Ivea.3/5, ku ka edhe selinë .

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë përfshin teknike, juridike etj. Sherbime te natyrave te ngjashme per te cilat shoqeria do te pajiset me licencat perkatese. Sherbime ne planifikim urban. Projektme interiere dhe pejsazhi, sistemim siperfaqe te gjelbra lulishte dhe parqe, Projektim dhe mbikqyrje aeroporte, heliporte, hekurudha,tunele rrugore-hekurudhore. Projektim e mbikqyrje vepra hidraulike. Studime dhe vleresime gjeologo inxhinierike dhe hidrogjeologjike te trojeve per objekte civile, per objekte te medha, porte e aeroporte, bazamente me ngarkesa te medha, i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet. Sherbime te natyres se projektmeve, mbikqyrje, kolaudim te impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise, studime te sizmiologjise inxhinierike, studime, projektme, mbikqyrje te ndertimit dhe mbylljes se venddepozitimeve te mbetjeve te ngurta. Studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri dhe ndertesave te cdo lloji. Hartimi i akteve te ekspertizes teknike per zjarret e rena. Sherbimet e Ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis .

Auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit ne mjedis. Ne fushen e dhenies me qera te autoveturave dhe mjeteve te tjera te transportit per pasagjere. Ne fushen e importit te autoveturave te perdorura dhe te reja si dhe tregtimin e tyre dhe te pjeseve te nderrimit te tyre.

Shoqëria është regjistruar prane Deges Rajonale Tatimore Tirane me NIPT K72113010E.

Kapitali i shoqërisë perbehet nga 100 kuota me vlere nominale 120.000 leke
A&E Engineering shpk është shoqëri shqiptare e zoteruar nga;
Zj. Entela Çano zoteruese e 100 kuotave apo 100% te kapitalit te shoqërisë.

Administratore e shoqërisë është zj. Entela Cano.

Numri i punonjesve me Dt 31.12.2021 është 26, dhe më Dt.31.12.2020 31.

2. Bazat e pregatitjes se Pasqyrave Financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmerise

Paqyrat financiare janë përgatitur, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të Permiresuara, të cilat përbëhen nga rregullat dhe interpretimet në përputhje me Ligjin nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Ne baze te urdhrin Nr.64 date 22.07.2014 "Per shpalljen e standarteve kombetare te kotabilitetit te permiresuara dhe zbatimin e detyrueshem te tyre". Ministria e Financave vendosi te beje te detyrueshem zbatimin e Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara duke filluar nga 1 Janar 2015.

Ky urdher hyri ne fuqi me publikimin ne fletoren Zyrtare Nr.119, date 01.08.2014

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane përgatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Biznesi ne vijimesi

Shenimet shoqeruese jane pjese perberse e ketyre pasqyrave financiare



Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK, monedhën shqiptare, e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerëne detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimivlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e



“A&E Engineering” shpk

Shënime të pasqyrave financiare

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

raportimit konvertohen në moned hën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar

njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në moned hën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
Eur/LEK	120.76	123.70
USD/ LEK	106.54	100.84

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithërisqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë se skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to maten mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.



“A&E Engineering” shpk

Shënime të pasqyrave financiare

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara menjëherë efektive të interesit.

Aktivet financiare të rendesishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tyre nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.



“A&E Engineering” shpk

Shënime të pasqyrave financiare

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyresh dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjestim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detajime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të



“A&E Engineering” shpk

Shënime të pasqyrave financiare

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetem qira operative. Pagesat e qirase operative njihen në pasqyrën e performancës me metoden lineare përgjate periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periud hën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.



3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Arka, banka dhe likuiditete të tjera janë likuiditete në monedhë vendi dhe të huaj me 31 dhjetor 2021, 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Llogari ne leke	7,300,616	35,253,809
Llogari ne monedhe te huaj	65,243	(8,664)
Arka	0	0
Totali	7,365,860	35,245,145

5. Llogari te arkëtueshme tregtare

Kërkesa të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021, 2020 janë si me poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Kliente	68,705,987	67,076,602
Totali	68,705,987	67,076,602

6. Kërkesa te arketueshme nga palet e lidhura

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Debitore kreditore te tjere, ortaku	0	5,323,135
Totali	0	5,323,135

7. Te tjera llogari te arketueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:



“A&E Engineering” shpk

Shënime të pasqyrave financiare

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Tatim fitimi	0	865,912
Totali	0	865,912

8. Aktivët afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale dhe lëvizjet e tyre deri më 31 dhjetor 2021, 2020 paraqiten si më poshtë:

	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje elektronike	Total
Kosto AAM				
1 Janar 2020	31,370,696	9,038,375	12,312,626	52,721,698
Shtesa	-	31,775	815,865	847,640
Pakesime/Axhustime	-	-	(176,250)	(176,250)
31 Dhjetor 2020	31,370,696	9,070,150	12,952,241	53,393,087
Kosto AAM				
1 Janar 2021	31,370,696	9,070,150	12,952,241	53,393,087
Shtesa	-	93,248	70,083	163,331
Pakesime/Axhustime	(9,497,570)	-	-	(9,497,570)
31 Dhjetor 2021	21,873,126	9,163,398	13,022,324	44,058,849
Amortizimi				
1 Janar 2020	13,127,662	5,195,148	9,831,206	28,154,016
Amortizimi vjetor	3,648,607	785,586	708,589	5,142,782
Rimarje amortizimi	-	-	(164,122)	(164,122)
31 Dhjetor 2020	16,776,269	5,980,734	10,375,674	33,132,676
Amortizimi				
1 Janar 2021	16,776,269	5,980,734	10,375,674	33,132,676
Amortizimi vjetor	2,876,693	629,509	1,048,176	4,554,378
Rimarje amortizimi	(5,503,182)	-	-	(5,503,182)
31 Dhjetor 2021	14,149,780	6,610,243	11,423,849	32,183,872
Vlera Neto 31 Dhjetor 2020	14,594,428	3,089,416	2,576,567	20,260,411
Vlera Neto 31 Dhjetor 2021	7,723,347	2,553,155	1,598,475	11,874,977

9. Llogari te pagueshme tregtare

Llogari te pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021, 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Furnitore	20,895,681	54,341,230
Totali	20,895,681	54,341,230

10. Detyrime tatimore

Detyrime tatimore me 31 dhjetor 2021, 2020 jane si me poshte:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Detyrime per sigurime shoqerore	348,150	382,963
Detyrime per tatime (tatim fitim)	1,635,648	0
Tvsh per tu paguar	5,014,378	4,521,639
	6,998,176	4,904,602



“A&E Engineering” shpk

Shënime të pasqyrave financiare

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

11. Te ardhura te shtyra

Te ardhura te shtyra per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 jane:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Te ardhura te periudhave te ardhshme	43,424,987	25,840,000
Totali	43,424,987	25,840,000

12. Te tjera detyrime

Te tjera detyrime per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 jane:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Detyrime per paga	537,669	1,011,786
Totali	537,669	1,011,786

13. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 120,000 Lekë i zotëruar si më poshtë përkatësisht për vitet 2021 dhe 2020

Ortaku	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Entela Cano	100	120,000	100%	100	120,000	100%
Totali	100	120,000	100%	100	120,000	100%

14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Te ardhura nga shitja	83,114,374	81,719,186
Te ardhura nga shitja e asetëve	2,809,959	21,167
Totali	85,924,332	81,740,353

Rakordimi i te ardhurave me deklaratat e TVSH

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Qarkullim i Tatueshem	103,509,319	99,080,354
Zbriten parapagimet ne celje	43,424,987	25,840,000
Shtohen parapagimet ne fund te vitit	25,840,000	8,500,000
Sipas kontabilitetit	85,924,332	81,740,354

15. Lënde e pare, materiale të konsumueshme dhe të tjera shërbime

Në këtë zë paraqiten kostot e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:



“A&E Engineering” shpk

Shënime të pasqyrave financiare

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Utilitete (energji, uje karburant)	2,461,491	1,378,218
Kancelari, shpenzime zyre	2,125,680	1,756,205
Siguracion	567,169	0
Shpenzime telekomunikacioni e postare	142,701	154,218
Mirembajtje e te ngjashme	1,329,598	1,281,224
Sherbime bankare	82,980	75,129
Taksa te tjera	241,014	73,398
Sherbime nga te trete	2,150,822	44,671,090
Shpenzime certifikimi	18,374,467	0
shpenzime te mbikqyrjes	9,174,227	974,680
Shpenzime perfaqesimi	0	56,000
Vlera neto e aseteve te shitura	3,994,388	12,126
Totali	40,644,538	50,432,288

16. Shpenzime për personelin

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Pagat e personelit	14,692,132	12,202,055
Sigururime shoqerore	2,416,366	1,997,264
Totali	17,108,498	14,199,319

17. (Shpenzime)/të ardhura financiare neto

(Shpenzime)/të ardhura financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesi dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Te ardhura nga interesat e fituara nga depozitat	0	0
Te ardhura nga interesat e fituara	0	0
Te ardhura financiare	-	-
Interesa te paguara	0	0
Humbja neto nga kembimet valutore	136,525	-267
Shpenzime financiare	136,525	(267)
Shpenzime financiare neto	136,525	(267)

18. Tatimi mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet më poshtë:

Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2020
--------------------------------------	--------------------------------------



“A&E Engineering” shpk

Shënime të pasqyrave financiare

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Humbja perpara tatimit

Fitimi para tatimit

23,480,394

11,966,231

Efekti tatimor i:

-Te ardhurave Te pa tatueshme

-

-

-Shpenzimeve te pazbritshme per tatim fitimin

1,472,239

0

Fitimi fiskal

24,952,633

11,966,231

Tatim fitimi I vitit I llogaritur me 15%

3,742,895

1,794,935

Shpenzimet e pazbritshme per tatim fitimin

2021

2020

Dhurata dhe shpenzime perfaqesimi

1,472,239

-

1,472,239

-

19. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treat. Bazuar ne opinionin e drejtuesve te Shoqerise, konkluzioni perfundimtar ne lidhje me keto ceshtje nuk do te kete efekte negative ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Me 31 Dhjetor 2021 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

20. Ngjarje pas dates se bilancit

Nuk ka asnje ngjarje pas dates se bilancit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare

